



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 41

Prishtinë, më 02.03.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Emin Gërbeshi

Mungoi: Anton Quni

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit të mbajtura më 16.02.2012;**
3. **Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës**
4. **Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.*

1. Miratimi i Rendit të ditës

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të mbajtura, më 16.02.2012

Kryetari i Komisionit- Konstatoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 16.02.2012 pa vërejtje.

3. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës

Kryetari i Komisionit- Sipas Planit të Punës së Komisionit konsideroj se është e nevojshme formimi i një grupi punues për të bërë mbikëqyrjen e këtij ligji dhe në përbërje të këtij grupi propozoj të jetë z. Rexhep Selimi, z. Fatmir Xhelili, z. Anton Quni dhe z. Goran Marinkovic ndërsa nga administrata do të jetë këshilltari z. Naim Hoxha dhe z. Haxhi Xhemajli.

Kryetari pyeti të pranishmit që a pajtohen me këtë propozim për këtë grup punues. Të gjithë votuan pro këtij propozimi.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Në këtë pikë të rendit të ditës kam disa njoftime bazuar në planin e punës së Komisionit.

Aktiviteti i parë është vizita studimore në Gjermani nga 25-31 mars, për këtë vizitë gjithashtu kam marrë një letër konfirmimi nga Ambasadori gjerman në Kosovë, që kjo vizitë është e garantuar dhe ka kërkuar takim pas kësaj vizite me të gjithë anëtarët e Komisionit.

Nga data 3-6 prill kemi vizitën e delegacionit hungarez dhe për këtë vizitë administrata është duke u marrë me agjendën dhe me organizimin në mënyrë që ky delegacion të ndahet me përshtypjet më të mira nga kjo vizitë.

Bazuar në planin e punës kemi edhe sfidat e Raportit të Progresit që lidhen me Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe mbikëqyrje të FSK-së, duhet ti bëjmë një kërkesë Ministrit të Punëve të Brendshme z. Bajram Rexhepi për një Raport që do ti ofrohej Komisionit në mënyrë që të shohim detyrat që janë zbatuar në bazë të Raportit të progresit dhe Ministri do të ftohet në takim me Komisionin pas ofrimit të këtij Raporti.

Rexhep Selimi- Sa i përket Raporteve që duhet të paraqiten në Komision, do të ri- ngrisë një çështje.

Inspektorati i Policisë, a ka marrë iniciativë për raportimin në Komision për të cilën gjë ka kërkuar Komisioni? Pasi në njërin nga mbledhjet e Komisionit kemi kërkuar që

Inspektorati i Policisë të na raportoj pasi ka kaluar një kohë prej kur Komisioni ka kërkuar një përgjigjeje, pasi ky raport do të ishte i mirë për Komisionin dhe për grupin punues-mbikëqyrës që do të jetë për ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Kryetari i Komisionit- Deri tani nuk kam pranuar asnjë përgjigjeje nga Inspektorati Policor por do ti bëjmë kërkesë që ta sjellin Raportin në Komision.

Rexhep Selimi- Duke qenë se deri tani Inspektorati Policor e ka pasur kohën e mjaftueshme për ta përgatitur Raportin e 14. janarit 2012, propozoj që me pajtimin e Komisionit të kërkojmë një afatizim për përgatitjen e këtij Raporti nga ana e Inspektoratit.

Kryetari i Komisionit- Do të bëjmë kërkesën për Inspektoratin Policor duke shpresuar që ta sjellin me kohë Raportin në Komision.

Fatmir Xhelili- Është ide e mirë informimi për aktualitetet, veprimtaritë e planifikuara dhe të realizuara nga Ministri a e Punëve të Brendshme si dhe segmenteve të cilët janë të kyçur në proces të liberalizimit të dala nga sugjerimet e Raportit të Progresit, mirëpo duke e pasur parasysh që Raporti i Progresit paraqitet në muajin tetor –nëntor, ka qenë kohë e shkurtër për arritjen e rezultateve pozitive.

Propozoj që kjo pikë të lihet për muajin qershor në mënyrë që për një periudhë shtatë mujore në mënyrë që të informohemi për aktivitetet e realizuara, në lidhje me këtë Qeveria ka krijuar një grup punues që në periudhë dy mujore raporton pranë Komisionit Evropian për të arriturat. Propozoj që këto Raporte ti paraqiten edhe Komisionit në mënyrë që të informohet për aktivitetet e realizuara si dhe raportimi i kohë pas kohshëm i Ministrisë të Punëve të Brendshme.

Goran Marinković- Pajtohem me z. Fatmir Xhelili që ti lihet kohë deri në muajin qershor për të parë arritjet në bazë të Raportit të Progresit.

Në këtë mbledhje të Komisionit nuk u përmend çfarë ka ndodhur në rajonin e Gjilanit ku janë arrestuar gjashtë qytetar serb. Ombudspersoni ka dhënë deklaratë që ka pasur ushtrim të dhunës ndaj tyre dhe një gjë e tillë është e pranueshme.

Sjellja e njësive ROSU ndaj banorëve është një formë e presionit që u bëhet atyre, gjithashtu kam informacione që Policia ka qenë jo korrekte gjatë arrestimit të këtyre qytetarëve. Për këtë arsyeje kërkoj që Ministri i Punëve të Brendshme apo Komandanti i këtyre njësive të paraqitet në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe mbikëqyrje të FSK-së për të shpjeguar se si ka ndodhur kjo situatë.

Dihet që njësit ROSU veprimtarinë e tyre duhet ta ushtrojnë në situata të tjera pasi në këtë rast këto njësi janë sjell si polici trafiku dhe një sjellje e tillë meriton reagim.

Kryetari i Komisionit- Si Komision kërkojmë nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Njësia Speciale kujdes ndaj qytetarëve të Kosovës pa dallime etnike. Nëse e

konsiderojmë të nevojshme mund të kërkojmë Raport nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe më pas të bëjmë vlerësimin, gjithashtu e drejtë e qytetarëve është që në rast se e konsiderojnë që janë tejkualuar kompetencat nga ana e policisë të ankohen pranë Inspektoratit Policor të Kosovës

Goran Marinković- Raste të tilla ka pasur edhe më herët dhe se sjellja ndaj civilëve në një mënyrë të tillë nuk është në rregull.

Fatmir Xhelili- Vlerësimin e tejkualimit të përdorimit të forcës në proporcion me nevojën e momentit duhet të vlerësohet nga një Komision i caktuar, grup ekspertësh që vlerësojnë nëse ka pasur tejkualim kompetencash.

Njësia speciale e Policisë vepron në bazë të parimeve dhe procedurave si dhe veprojnë ndaj atyre rasteve që janë objekt, në bazë të autorizimeve të Prokurorisë apo konstatime se janë shkelës të ligjit në Kosovë.

Për çdo dyshim eventual për tejkualim kompetencash nga ana e Policisë, ekziston organet e ankesës ku mund të paraqiten ato siç është Inspektorati Policor i Kosovës që të konstatohet nëse është tejkualuar përdorimi i forcës dhe se çdo ankesë individuale merret shume seriozisht nga ana e Inspektoratit Policor.

Rexhep Selimi- Çdo shenjë e jo profesionalizmit nga ana e Policisë së Kosovës është shqetësuese për neve, por trajtimi i një teme të tillë duhet të dihet a është pjesë e fushëveprimtarisë së Komisionit për çdo tregues të jo profesionalizmit eventual që mund të ndodh nga veprimi i Policisë në terren.

Çështja që duhet të ngjitet është se, a jemi organi që duhet të adresohen këto çështje dhe çfarë mund të ndihmojmë nëse adresohen pran këtij Komisioni, pasi Komisioni si i tillë ka funksionin e mbikëqyrjes së zbatueshmërisë së ligjit.

Detyra e policëve është zbatimi i urdhëresave, dhe çështja nis e kanë zbatuar apo jo nuk është çështje që duhet të shtrohet pran Komisionit për Punë të Brendshme dhe Mbikëqyrje të FSK-së, gjithashtu edhe nëse ka pasur tejkualim të përdorimit të dhunës ndaj qytetarëve Komisioni nuk është organi adekuat për ta adresuar atë.

Goran Marinković- Nuk kam dëshirë të fajësoj askënd apriori por desha të theksoj deklaratën e Ombutspersonit pasi kjo e dëmton Policinë e Kosovës dhe nëse kjo polici motivohet mbi baza etnike kjo gjë nuk është pozitive.

Kryetari i Komisionit- Pas vlerësimit të z. Marinković, vlerësojmë që pas përfundimit të procedurave nga organet hetimore për këta të dyshuar. Gjatë kësaj kohe nëse vërejmë që ka pasur tejkualim kompetencash ndërmarrim hapa pranë Komisionit, por me që janë nën hetime pas vendimeve të organeve kompetente, do të jemi të informuar për këtë rast në Komision.

Propozimi i z. Fatmir Xhelili që të kemi një Raport nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme deri në muajin qershor nuk u mbështet nga të gjithë anëtarët.
Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45

Përgatitur nga:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi